



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

**Nr. 94 Akti**

**V E N D I M**

**Nr.5, datë 24.7.2020**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Genta Tafa (Bungo)	Kryesuese
Etleda Çiftja	Relatore
Pamela Qirko	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Olsida Goxhaj, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, në datën 22.7.2020, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket, subjektit të rivlerësimit, z. Artan Çupi, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat.

**V Ë R E N:**

**I. RRETHANAT E ÇËSHTJES**

**1.** Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në paragrafin 5, të nenit 179/b, të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në pikën 5, të nenit 3, dhe në pikën 1, të nenit 5, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**2.** Subjekti i rivlerësimit, z. Artan Çupi, aktualisht me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat, është subjekt i rivlerësimit, që i nënshtrohet rivlerësimit, *ex officio*, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

**3.** Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016 dhe në Rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni), ka hedhur shortin në datën 15.3.2018, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Artan Çupi, do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Pamela Qirko, Etleda Çiftja dhe Genta Tafa (Bungo). Relator i çështjes, u zgjodh me short, komisionerja Etleda Çiftja.

**4.** Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 26.3.2018, u caktua me mirëkuptim kryesuese komisionerja Genta Tafa (Bungo), u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e

trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Artan Çupi.

**5.** Në referim të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit, z. Artan Çupi, nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016 për të vlerësuar të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit. Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016.

**6.** Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK); dhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë (tashmë KLGJ). Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.

**7.** Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për të tri kriteret, në datën 29.5.2020, vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Artan Çupi, bazuar në relatin mbi rezultatet e hetimit të paraqitur nga relatori i çështjes; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t’u njohur me provat e administruar nga Komisioni në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe me nenet 45-47 dhe 35-40 të Kodit të Procedurës Administrative; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur prova dhe shpjegime, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5, të nenit Ç, të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016.

**8.** Në datën 15.6.2020, subjekti i rivlerësimit, përmes postës elektronike<sup>1</sup> kërkoi kohë për të paraqitur shpjegimet dhe provat në mbështetje të barrës së provës, kaluar me relacionin mbi rezultatet e hetimit kryesisht.

**9.** Trupi gjykues, pasi shqyrtoi kërkesën e subjektit të rivlerësimit, vendosi t’i japë subjektit 5 ditë shtesë për të paraqitur shpjegimet dhe provat duke i njoftuar edhe caktimin e seancës dëgjimore në datën 26.6.2020.

**10.** Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes në datën 3.6.2020.

**11.** Në datën 17.6.2020, subjekti i rivlerësimit, paraqiti shpjegimet e kërkuara në relacionin mbi rezultatet e hetimit kryesisht së bashku me provat e reja në mbështetje të barrës së provës.

**12.** Komisioni, përmes postës elektronike<sup>2</sup>, njoftoi subjektin e rivlerësimit se seanca dëgjimore e datës 26.6.2020, ora 10:45, do të shtyhet deri në një njoftim të dytë, për arsye objektive të mungesës së njërit prej anëtarëve të trupit gjykues.

**13.** Në vendimin e datës 14.7.2020, trupi gjykues vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, z. Artan Çupi, në seancë dëgjimore në përputhje me nenin 55, të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit në vijim të komunikimit në lidhje me datën dhe orën e ftesës për seancë dëgjimore, e cila nuk u zhvillua në datën 26.6.2020, për arsye objektive, u njoftua përmes postës elektronike<sup>3</sup> për seancën dëgjimore, që u zhvillua në datën 22.7.2020, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, kati 0, Tiranë.

---

<sup>1</sup> E-mail, datë 15.6.2020, ora 9:04, në përgjigje të e-mail-it, “Komisioni – njoftim për mbylljen e hetimit kryesisht për procesin tuaj të rivlerësimit”.

<sup>2</sup> E-mail, datë 22.6.2020, ora 13:32, “Njoftim për shtyrje të datës së zhvillimit të seancës dëgjimore”.

<sup>3</sup> E-mail, datë 14.7.2020, ora 15:57, “Njoftim për shtyrje të datës së zhvillimit të seancës dëgjimore”.

## II. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

**14.** Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar -Vetting”; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) “Deklaratën e Rivlerësimit Kalimtar -Vetting” të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, të cilat gjenden në dosjen e këtij subjekti, dërguar në Komision; (d) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (dh) raportet e kontrollit të figurës të dorëzuar pranë këtij Komisioni nga DSIK-ja; (e) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLD; (ë) denoncimet e publikut; si dhe (f) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit, apo nëpërmjet postës elektronike, si dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

**15. Komisioni vlerëson që në këtë vendim të trajtojë vetëm vlerësimin e subjektit në lidhje me kriterin e aftësive profesionale bazuar në Aneksin E dhe pikën 2, të Aneksit E, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.**

**16.** Në lidhje me dy kriteret e tjera, Komisioni do të shprehet në vendimin përfundimtar, pasi subjekti të ketë përfunduar programin e edukimit njëvjeçar pranë Shkollës së Magjistraturës dhe të jetë testuar për aftësitë e tij.

### A. VLERËSIMI PROFESIONAL

**17.** Komisioni, pasi analizoi raportin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, të dhënat e administruara nga Ministria e Drejtësisë dhe KLD-ja, ankesat e publikut, shpjegimet e subjektit pas kalimit të barrës së provës, si dhe e dëgjoji atë në seancë dëgjimore, konstaton se:

**i)** Subjekti ka lëshuar një urdhër ekzekutimi në një kohë kur marrëdhënia ligjore për të siguruar pezullimin e kryerjes së punimeve është shuar për shkak të heqjes së masës së sigurimit të padisë.

Subjekti, të paktën në një rast, ka treguar njohuri dhe aftësi të cekëta në lidhje me normat procedurale civile, të cilat konsiderohen mangësi profesionale.

**(ii)** Subjekti në një rast ka marrë parasysh kërkesat e nenit 260 të Kodit të Procedurës Penale, pasi ka vendosur zëvendësimin e masës së sigurimit nga “arrest në burg” në “arrest në shtëpi”, ndërkohë që nuk rezulton e provuar të jenë ndryshuar rrethanat e faktit dhe as të jenë zbutur nevojat e sigurimit ndaj të pandehurve, pra, nuk ka qenë asnjë nga kriteret e parashikuara në nenin 260/2 të Kodit të Procedurës Penale.

Subjekti ka treguar njohuri dhe aftësi të cekëta në lidhje me analizimin e ndryshimit të masës së sigurimit, të cilat konsiderohen mangësi profesionale.

**iii)** Subjekti në dispozitivin e vendimi të ndërmjetëm nr. \*\*\*, datë 11.12.2006, është shprehur se kundër këtij vendimi lejohet ankim i veçantë në Gjykatën e Apelit, disponimi i cili është i pambështetur në ligjin procedural civil.

Subjekti ka treguar njohuri dhe aftësi të cekëta në lidhje me fazën procedurale të ankimimit të vendimeve të ndërmjetme, të cilat konsiderohen mangësi profesionale.

**iv)** Subjekti ka gjykuar çështjen për një periudhë prej 1 vit e 17 ditë, në tejkalim të parashikuar

në nenin 5, germa “a”, të vendimit nr. \*\*\*, datë 14.4.2010, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, “Mbi kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”, afat ky që për çështjen penale objekt verifikimi, nuk duhet të kalojë më shumë se 9 muaj.

Subjekti nuk rezulton të ketë qenë efektiv në gjykimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm duke treguar mangësi profesionale

v) Subjekti nuk ka marrë asnjë masë lidhur me shtyrjet e seancave gjyqësore si rezultat i mungesës së avokatëve, gjë që ka çuar në zvarritjen e procesit gjyqësor.

Subjekti nuk rezulton të ketë qenë efektiv në gjykimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm duke treguar mangësi profesionale.

vi) Të paktën në një rast, subjekti nuk ka argumentuar plotësisht vendimin, pasi nuk ka analizuar të gjitha provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Subjekti ka treguar njohuri dhe aftësi të cekëta dhe gjykim të dobët, të cilat konsiderohen mangësi profesionale.

**18.** Në përfundim të rivlerësimit për kriterin e vlerësimit profesional, Komisioni çmon se subjekti ka shfaqur njohuri, aftësi dhe gjykim të cekët në punën profesionale të tij, si vijon:

- në 4 raste, Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka treguar njohuri dhe aftësi të cekëta në gjykimin e çështjes;
- në 2 raste, Komisioni ka konstatuar se subjekti nuk ka qenë efektiv pasi ka zvarritur procesin.

**19.** Komisioni konkludon se subjekti ka pasur detyrimin ligjor të thellohej në arsyetimin e vendimeve, të kontrollonte lidhjen logjike të argumentave si detyrim ligjor i përcaktuar nga ligji procedural penal dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

## **KONKLUZION**

**20.** Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konstaton se subjekti ka shfaqur mangësi në aftësitë e tij profesionale, të cilat mund të plotësohen nëpërmjet programit të trajnimit pranë Shkollës së Magjistraturës.

## **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, në bazë të nenit 58, pika 1, germa “b”, nenit 44/b, si dhe të nenit 60, pika 1, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

## **V E N D O S I:**

- 1.** Pezullimin nga detyra të z. Artan Çupi për një periudhë një vjeçare dhe detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit, sipas kurrikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës.

2. Në përfundim të këtij trajnimi, pas administrimit të rezultateve të arritura nga subjekti, Komisioni do të përfundojë procesin e rivlerësimit bazuar mbi të tri kriteret e vlerësimit.
3. Ky vendimi i njoftohet subjektit të rivlerësimit, vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe Shkollës së Magjistraturës brenda 30 ditëve pas kësaj seance dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
4. Ky vendim është i paankimueshëm, bazuar në pikën 2, të nenit F, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

## **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Genta TAFA (BUNGO)**

**Kryesuese**

**Pamela QIRKO**

**Anëtare**

**Etleda ÇIFTJA**

**Relatore/kundër**

*Sekretare gjyqësore  
Olsida Goxhaj*